



Kolegji ESLG

KODI I MIRËSJELLJES PËR STAFIN JOAKADEMIK

Neni 1

Stafi joakademik nuk duhet të zbulojë informatat konfidenciale apo dokumentet zyrtare të Kolegjit pa lejen nga autoriteti përkatës.

Neni 2

Stafi joakademik nuk vonon punën zyrtare, korrespondencën zyrtare apo detyrën e tij zyrtare.

Neni 3

Stafi joakademik i Kolegjit duhet të kushtojë vëmendje të shpejtë dhe të kujdesshme ndaj punëve që kanë të bëjnë me reputacionin dhe integritetin e Kolegjit.

Neni 4

Anëtari i stafit nuk do të jetë anëtar apo nuk do të jetë pjesë e ndonjë shoqërie apo shoqate apo organizate e cila nuk është në pajtim me funksionin dhe dinjitetin e detyrës së tij/saj në universitet

Neni 5

Anëtari i stafit nuk guxon të pranojë apo të shkaktojë personin tjetër që të pranojë dhuratë si shkëmbim për punën e tij/saj zyrtare në kuadër të Kolegjit.

Neni 6

Anëtari i stafit është i obliguar që të ruajë pasurinën e Kolegjit e cila i është besuar atij me zell dhe integritet.



Kolegji ESLG

Neni 7

Sanksionet

Kodi i Mirësjelljes është obligativ për tërë stafin joakademik dhe në rast të nevojës për shqiptimin e sanksioneve universiteti do t'i referohet statutit dhe rregullave dhe rregulloreve tjera të Kolegjit.

Neni 8

Hyrja në fuqi

8.1 Ky kod hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Presidenti i Bordit Menaxhues.

Prof. Dr. Edmond Hajrizi, 20.08.2019

